15	Kolle per ngjitje dhe rrafshim ngjyyre gri dhe i bardhe
16	Beton M-250
17	Beton I gatshem ne thase (25-30 kg) me ngurtesim te shpejte me ngjyre te zeze dhe gri.
18	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=150 mm
19	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=200 mm
20	Rakorderi HDPE SN8 D=200 mm
21	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=250 mm
22	Rakorderi HDPE SN8 D=250 mm
23	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=315 mm
24	Rakorderi HDPE SN8 D=315 mm
25	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=400 mm
26	Rakorderi HDPE SN8 D=400 mm
27	Kapak gize
28	Bordura betoni 15x25 cm
29	Bordure betoni 15x30 cm
30	Bordura betoni 12x25cm
31	Bordura betoni 8x20cm
32	Pllaka betoni
33	Pllaka guri
34	Hekur betoni i zakonshëm Ø 6 ë 10mm
35	Dërrase per kallepe
36	Gozhde

Për vitin 2027 & 2028

Vlerësimi dhe përcaktimi i prioriteteve të shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugeve dhe trotuareve në qytet;
Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve
Përcaktimi i volumeve të punës
Blerje bazë materiale për ndërhyrjet në rrugët dhe trotuaret qytet
Blerje mjete pune per realizimin e punimeve
Blerje pajisje pune te domosdoshme për realizimin e punes.
Blerje vegla pune, veshje sigurie, dhe sinjalistike kantieri.
Alokimi i fondeve, monitorimi i realizimit të shërbimeve sipas kalendarit të ndërhyrjeve dhe volumeve të punës të parashikuar.
Administrim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore.

b) Rezultatet që prisni

Përmirësimi i sipërfaqeve të dëmtuara të rrugëve dhe trotuareve;
Krijimi i bazës së saktë të të dhënave për nevojën për mirëmbajtje në rrugë dhe trotuare në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës.
Të reduktojë kostot për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes në qytet nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe burimeve njerëzore të Ndërmarrjs së Shërbimeve dhe Punëve Publike.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike Drejtoria e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Lagjet nr.1, 2, 3, 4 dhe 5 në qytet.	Buxheti i Bashkisë

e) Shpenzimet e llogaritura

Drejtoria e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës sipas nevojës së verifikuar dhe prioritetit do të bëjë detajimin e planit sipas zërave të mësipërm dhe do të monitorojë realizimin e kryerjes së shërbimit.

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2026		Totali (000/lekë)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Blerje baze materiale per infrastrukturen.	**15,500**		15,500	
A.2	Blerje pajisje pune	**6,500**		6,500	
A.3	Blerje pajisje pune per matje topografike	**3,000**		3,000	
A.4	Blerje eskavator me goma me matrapik + kove.				
Shuma		**25,000**		**25,000**	
Shpenzimet sipas aktiviteteve 2027		Totali (000/lekë)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet.	**25,000**		25,000	
Shuma		**25,000**		**25,000**	
Shpenzimet sipas aktiviteteve 2028		Totali (000/lekë)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale

A.1	Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet	**25,000**		25,000	
Shuma		**25,000**		**25,000**	
f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Mirembajtjes se Infrastruktures **Institucioni likujdues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike			

Nr. 9	**P.AE141.Q2.O2.A1**. Mirëmbajtje e rrugëve Rurale	**Programi AE141:** Sherbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015, datë 17. 12. 2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23 "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike'', pika 4: Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore" Bashkia e Shkodrës është përgjëgjëse në territorin e juridiksionit të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 915,datë 11.11.2015, "Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve te Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëvë", neni1, ka kaluar në administrim të Bashkisë së Shkodrës fondin e rrugëve rurale sipas tabelës:

Nr	Emërtimi i rrugës	km
1	Fermentim – Ura e Mesit – Muri i Turkut	19
2	Ura e Mesit – Prekal – Kir – Breg Lumit – Theth	72
3	Guri Mashter – Komuna Pog	4
4	Degëzim Ndrejaj – Komuna Shosh	1.5
5	Degëzim asfalti rruga Velipojë – Komuna Dajç	7,5
6	QafëThore – Thethe	16
7	Rr. Harku Berdices – D/Anashkalimi	3.5
TOTALI		123.5

Përveç rrjetit të rrugëve rurale të mësipërm, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 dt. 17. 12. 2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 23, Bashkia Shkodër ka në administrim edhe rrjetin rrugor të rrugëve lokale të njësive administrative si më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Gjatësia km	Numri i Rrugëve
1	Njësia Administrative Bërdicë	31	57
2	Njësia Administrative Velipojë	40.5	38
3	Njësia Administrative Dajç	61.1	61
4	Njësia Administrative Rrethina	108	218
5	Njësia Administrative Postribë	78	51
6	Njësia Administrative Ana e Malit	71.2	100
7	Njësia Administrative Guri i Zi	60	94
	Totali	449.8	619

Mirëmbajtja e rrjetit rrugor rural në Bashkinë Shkodër kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike. Ndërmarrja do të kryej një numër aktivitetesh (pune dhe shërbimi) me qëllim që të arrijë nivelin e kërkuar të shërbimit për përdoruesit e rrugës në të gjithë rrjetin rrugor rural. Në mënyrë specifike, punimet e mirëmbajtjes që do të kryhen konsistojnë në:

Punime rehabilitimi të rrugëve: punime që kryhen me qëllim për ta sjell rrugën në standarte të pranueshme. Këto punime i referohen tëgjithë komponenteve të rrugës (drenazheve, punimeve te dheut, strukturave, shtresave asfaltike, vegjetacionit etj.)

Punimet e rehabilitimit përfshijnë punimet e mëposhtme:

Riparimin e defekteve të rrugës (siç janë gropat, gjurmët e gomave të makinave, plasaritjet në shtresën qarkulluese, skajet e dëmtuara dhe të deforuara të rrugës etj)
Riveshje e sipërfaqes së pjesës kaluese/karrexhatës
Mbushje dhe profilim i nënshtresave të rrugëve me asfalt
Parandalimin e erozionit të argjinaturës, rrëshqitjes së shkëmbinjëve dhe vendosjen e sistemeve mbrojtëse të nevojshme
Mbushje dhe profilim në rrugë të pashtruara
Mbushja dhe nivelimi i bankinave
Punimet e riparimit në skarpata
Përmirësim i sistemit të kullimit të rrugës
Kontrolli i vegjetacionit
Mirëmbajtjen e veprave të artit: ura dhe mure mbajtëse e pritëse.
Riparimi dhe rifreskimi i pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike)
Shërbime për mirëmbajtjen dimërore (sigurimi i kripës ose materialeve alternative) etj

Sfidat që paraqiten

Bashkia e Shkodrës ka trashëguar një infrastrukturë të dobët rrugore që kalon në zona fushore dhe të thella malore.
Një numër i aktiviteteve të mirëmbajtjes janë të lidhura drejtpërdrejt me stinët, dhe vecanarisht me periudhën e dimrit dhe pranverës. Këto aktivitete kërkojnë një monitorim të mirë të kushteve të motit për ndërhyrjen dhe parandalimin e dëmtimeve të rrugës dhe zgjatur jetëgjatësinë e saj.
Rrjeti rrugor rural shtrihet në zona të thella malore dhe mirëmbajtja e tyre është e kufizuar për shkak të fondeve. Gjendja paraqitet më e rënduar sidomos në rrjetin rrugor të pashtruar ku prurjet e shumta nga shirat e rrëmbyer dhe inertet që vijnë

nga shpatet kanë gërryer dhe prishur trupin e rrugës duke vështirësuar qarkullimin dhe rrezikuar kalimin e mjeteve në këto rrugë.
Është e vështirë mirëmbajtja e këtyre rrugëve për shkak se fillimisht duhet të kryhet një numër i madh aktivitetesh (pune dhe shërbimi) me qëllim që rruga të arrijë nivelin e kërkuar të shërbimit për përdoruesit e rrugës dhe më pas të vazhdohet me mirëmbajtjen e saj.
Rrjeti rrugor i asfaltuar ka probleme që vijnë kryesisht nga ndërhyrjet e vazhdueshme në infrastrukturë për shtrimin e rrjeteve nëntokësore dhe punimet e kryera jashtë standarteve nga operatoret privat kanë rritur shkallën e amortizimit të tyre.
Një problem tjetër është mbushja e kanaleve anësore të rrugës me inerte dhe materiale të ndryshme nga banorët për të kryer aksesin në pronat e tyre gje që ka sjell probleme me kullimin e rrugës.
Nga verifkimi ne terren kemi konstatuar qe barrierat mbrojtese te rruges (guardrail) ne disa rruge kryesore mungojne ose jane demtuar per shkak te aksidenteve rrugore. Por ka edhe akse rrugore ku barrierat e sigurise rrugore jane te domosdoshme por mungojne plotesisht. Hap pas hapi sektori i mirembatjes se infrastruktures po ben azhornimin e gjendjes faktike dhe ne baze te prioriteteve do te ndermarre hapat per rritjen e sigurise rrugore sidomos ne rruge me qarkullim te larte, kthesa te forta, prane veprave te ndryshme te artit etj

ii. Synimi i projektit

Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë;
Të përmirësojë rrjetin rrugor, nëpërmjet rehabilitimit dhe përmirësimit të rrugëve ekzistuese rurale dhe të mundësoje lidhje të reja ndërmjet fshatrave. Të rrisë aksesin ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.
Rritjen e jetëgjatësisë së rrugëve
Të rrisë sigurinë e lëvizjes në rrugë të automjeteve;
Të reduktojë kostot për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe burimeve njerëzore të Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Për vitin 2026
Vlerësimi dhe përcaktimi i prioriteteve të shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore;
Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve;
Përcaktimi i volumeve të punës;
Blerje bazë materiale për ndërhyrjet në rrugët rurale dhe njësitë adminstrative;

Nr.	Përshkrimi I Materialeve
1	Zhavorr lumi
2	Çakelli mbeturine kave
3	Stabilizant
4	Binderi me granil gur kave
5	Asfaltobetoni me granil guri kave
6	Bitum M-3 (leng)
7	Konglomerat bituminoz (i ftohtë)
8	Çimento 32.5 N
9	Çimento 42.5 R
10	Rërë e larë lavatrice
11	Rërë lumi
12	Rërë guri
13	Zall I larë lavatrice 5-10 mm
14	Cakell per betone (granil)
15	Kolle per ngjitje dhe rrafshim ngjyyre gri dhe i bardhe
16	Beton M-250
17	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=150 mm
18	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=250 mm
19	Rakorderi HDPE SN8 D=250 mm
20	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=315 mm
21	Rakorderi HDPE SN8 D=315 mm
22	Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 D=400 mm
23	Rakorderi HDPE SN8 D=400 mm
24	Bordura betoni 15x25 cm
25	Bordure betoni 15x30 cm
26	Pllaka betoni 6 cm
27	Hekur betoni i zakonshëm Ø 6 ë 10mm
28	Konstruksione metalike te thjeshta
29	Kapak gize
30	Dërrase per kallepe
31	Gozhde
32	Tuba çeliku te zi me tegel
33	Rakorderi çelik I zi
34	Derrase pishe e stazhionuar 50 mm
35	Tub betoni Ø 400 mm

36	Tub betoni Ø 600 mm
37	Tub b/a Ø 800 mm
38	Tub b/a Ø 1000 mm

Alokimi i fondeve, monitorimi i realizimit të shërbimeve sipas kalendarit të ndërhyrjeve dhe volumeve të punës të parashikuar;
Rritja e sigurise rrugore ne rruget me levizje te larte dhe prane veprave te artit.
Administrim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore.
Referuar nevojës së verifikuar në vite për ndërhyrje në mirëmbajtje do të parashikohen shpenzime sipas vlerësimit të dëmtimeve të mundshme të infrastrukturës si pasojë e agjenteve atmosferik dhe amortizimit.
Për vitin 2027 & 2028
Vlerësimi dhe përcaktimi i prioriteteve të shërbimeve të riparimit dhe mirmbajtjes infrastrukturës rrugore;
Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve
Përcaktimi i volumeve të punës
Blerje bazë materiale për ndërhyrjet në rrugët rurale
Alokimi i fondeve, monitorimi i realizimit të shërbimeve sipas kalendarit të ndërhyrjeve dhe volumeve të punës të parashikuar.
Administrim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore.

b) Rezultatet që prisni

Sigurimi i qëndrueshmerise dhe funksionalitetit afatgjate te rrjetit rrugor nepermjet sherbimeve te mirembajtjes.
Rritjen e sigurise rrugore. Zvogelim i kohes së udhëtimit dhe ulje e kostos së amortizimit të mjeteve;
Permirësimin e infrastruktures dhe lidhja e rrugëve rurale me rrugët nacionale, qendrat e fshatrave me rrugët nacionale dhe qendrat e fshatrave brenda njësive administrative.
Zvogëlimin e kostove të mirëmbajtjes së rrugëve rurale me punonjesit Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe pergjigjen ne kohe per nderhyrje emergjente.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike Drejtoria e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Njësitë administrative: Pult, Shosh, Shalë, Postribë, Guri i Zi, Bërdicë, Velipojë, Dajç, Ana e Malit, Rrethina.	Bashkia e Shkodrës

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje baze materiale per infrastrukturen ne NJ.A	**12,505**			12,505		
A.2	Punime sherbimi per rritje e sigurise rrugore.	**12,000**			12,000		
Shuma		**24,505**			**24,505**		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbime riparimi të akseve të rrugëve	**24,505**			24,505		
Shuma		**24,505**			**24,505**		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbime riparimi të akseve të rrugëve	**24,505**			24,505		
Shuma		**24,505**			**24,505**		

f) Periudha e zbatimit	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
Janar 2026- Dhjetor 2028	Drejtoria e Mirembajtjes se Infrastruktures **Institucioni likujdues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 10	**P.AE141.Q2.O2.A2**. Rikonstruksion i urave ne fshatin turistik Theth.	**Programi AE141**. Shërbimet publike vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Duke qene se fshati turistik Theth mirepret çdo vit e me shume turiste si vendas ashtu edhe te huaj, lind nevoja e mirembajtjes dhe e rikonstruksionit te urave egzistuese, qe sherbejne edhe si ura turistike ne kete zone. Infrastruktura e ***veprave te artit, (ura me kavo), eshte shume e amortizur, demtuar***, prandaj detyrimisht duhet te planifikojme te nderhyret ne kete vite.

ii. Synimi i projektit

Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së veprave te artit, në pronësi të Bashkisë;
Të përmirësojë veprat e artit qe ne kete zone sherbejne edhe si atraksione turistike.
Të rrisë sigurinë e lëvizjes se kembesoreve, si banoreve vendas edhe turisteve;
Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së urave, në pronësi të Bashkisë;

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Evidentimi I veprave te artit tek te cilat duhet te nderhyret
Ndjekje, monitorim dhe raportim të punimeve të kryera, të dhëna vlerësuese për punën e kryer (km, volume, sipërfaqe, nr. përfituesish, buxhet i shpenzuar, etj.)

b) Rezultatet që prisni

Sigurimi i qëndrueshmerise dhe funksionalitetit afatgjate te veprave te artit nepermjet rikonstruksioneve dhe sherbimeve te mirembajtjes.
Rritjen e sigurise per banoret dhe turistet.
Permirësimin e infrastruktures

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike Njësitë administrative: Shalë	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Rikonstruksion i urave ne fshatin turistik Theth	**12,000**					12,000
A.1.1	*Rikonstruksion i urave ne fshatin turistik Theth- Zbatim*	*10,597*					*10,597*
A.1.2	*Rikonstruksion i urave ne fshatin turistik Theth-Mbikqyrje*	*441*					*441*
A.1.3	*Rikonstruksion i urave ne fshatin turistik Theth-Kolaudim*	*25*					*25*
A.1.4	*Rikonstruksion i urave ne fshatin turistik Theth-Projektim*	*937*					*937*
Shuma		**12,000**					**12,000**

f) Periudha e zbatimit Viti 2026	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Sektori I Kullim -Ujitjes **Institucioni likuidues**: Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike

Nr.11	**P.AE141.Q3.O1.A1:** Paga dhe sigurime te stafit	**Programi AE141**: Sherbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Paga dhe shtesat mbi paga
Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të VKM nr. 113 dt.01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" ,VKM nr. 326 dt. 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, VKM nr.503 date 01.08.2024 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore
Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.
Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve: Paga, Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

b) Rezultatete pritshme

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.
Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Bashkia Shkoder

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026		Total (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	**9,772**	9,772				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	**1,554**		1,554			
A.3.	Dieta për punonjësit	**10**			10		
Shuma		**11,336**	**9,772**	**1,554**	**10**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**9,772**	9,772				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**1,554**		1,554			
A.3	Dieta për punonjësit	**10**			10		
Shuma		**11,336**	**9,772**	**1,554**	**10**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**9,772**	9,772				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**1,554**		1,554			
A.3	Dieta për punonjësit	**10**			10		
Shuma		**11,336**	**9,772**	**1,554**	**10**		

f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Sektori Ekonomik Financiar **Institcioni likujdues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 12	**P.AE141.Q3.O1.A2:** Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit	**Programi AE141**: Sherbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Sektori i sinjalistikës rrugore ka 4 mjete në administrim të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve, transportimin e punonjësve me materialet dhe pajisjet e nevojshme në territorin e Bashkisë në qytet dhe Njësitë Administrative.
Mjetet në funksion kanë nevojë vazhdimisht për shërbime mirëmbajtje periodike, riparimin e defekteve që mund të dalin gjatë punës, furnizim me karburant, shërbimin e kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracioneve gjatë vitit.

ii. Synimi i projektit

Mjete transporti funksionale, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të punonjësve te NSHPP sipas nevojave që ato kanë.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

-Vlerësimi i gjendjes teknike të mjeteve të transportit në serviset e liçensuara dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të riparohen dhe të kthehen apo të mbahen në gjendje pune.
-Identifikimi i nevojave për karburant, pjesë këmbimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtyre automjeteve.
-Përgatitja e preventivave dhe dokumentacioneve përkatëse të nevojshme për prokurim.
-Zbatimi i procedurave të prokurimit sipas specifikimeve teknike të paracaktuara dhe monitorimi për:
Blerje karburanti
Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit
Siguracioni i automjeteve
Taksa qarkullimi, kolaudimi
Marrja në dorëzim e shërbimeve të mjeteve.

b) Rezultatet e pritshme

Mjete transporti në gjendje të mirë pune në gatishmëri më të lartë për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme sipas nevojave.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Ndriçimit rrugor dhe sinjalistikës Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2026		Totali (000 lekë)	Nga kjo :			
			Paga.sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje karburanti	**1,815**		1,815		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit	**168**		168		
A.3	Shpenzime për sigurimin e automjeteve	**38**		38		
A.4	Shpenzimi i taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**17**		17		
Shuma		**2,038**		**2,038**		

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2027		Totali (000 lekë)	Nga kjo :			
			Paga.sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje karburanti	**1,815**		1,815		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit	**168**		168		
A.3	Shpenzime për sigurimin e automjeteve	**38**		38		
A.4	Shpenzimi i taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**17**		17		
Shuma		**2,038**		**2,038**		

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2028		Totali (000 lekë)	Nga kjo :			
			Paga.sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje karburanti	**1,815**		1,815		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit	**168**		168		
A.3	Shpenzime për sigurimin e automjeteve	**38**		38		
A.4	Shpenzimi i taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**17**		17		
Shuma		**2,038**		**2,038**		

f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 13	P.AE141.Q3.O1.A3: Lëvizshmëria dhe sinjalistika	Programi AE141. Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Gjatë vitit 2025 është kryer mirëmbajtja e sinjalistikës horizontale dhe vertikale dhe vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, parkingjet për persona me aftësi ndryshe, vendqëndrimet e transportit publik, të vendqëndrimeve taxi korsitë e biçikletave dhe vijëzime të këmbësorëve në degëzimet kryesore.
Shërbimi i sinjalistikës është realizuar edhe në njësitë e tjera administrative kryesisht në Nj.A Velipojë, para fillimit të sezonit të plazhit por edhe në zonat e banuara të njësive administrative Rrethina, Guri Zi, Bërdicë, Postribë dhe Ana e Malit.
Është bërë plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale, në të gjitha rrugët e rikonstruktuara me financimet e Bashkisë Shkodër.
Është realizuar plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale, i korsive të dedikuara për bicikleta. Ky proces vazhdon me zgjerimin e korsive të dedikuara edhe në rrugët e tjera.
Gjatë vitit 2025 janë krijuar 5 130 metër linear korsi bicikletash në rrugët:
Sheshi Zogu i Pare (segment), Rruga Studenti, Rruga Martin Camaj, Rruga Qemal Dracini, Rruga Europa, Rruga Pogaj, Unaza Perëndimore (vazhdim), Unaza Lindore (Rrotondo Rus-Sheshi i Spitaleve), Unaza Lindore (Rruga Hile Mosi dhe Marije Shllaku).
Krahas investimeve të realizuara në korsitë të dedikuara për bicikleta gjatë gjithë vitit realizohet dhe mirëmbajtja e infrastrukturës që dëmtohet nga mjetet dhe qytetarët.
Situata e vlerësuar:
Trafik i ngarkuar si rezultat i qarkullimit të automjeteve në akset kryesore dhe në qendër të qytetit,
Nevoja për plotësim me sinjalistikë për kufizim shpejtësie për rritjen e sigurisë rrugore, në pika të caktuara.
Krahas semaforëve që janë tashmë të vendosur në 2 kryqezime, ka nevojë për vendosjen e tyre edhe në sheshe e rrugë të tjera për përmirësimin e lëvizshmërisë dhe rritjen e sigurisë për përdoruesit e rrugës nga këmbësorët dhe përdoruesit e mjeteve.
Përmirësimi i infrastrukturës dhe sinjalistikës për krijimin e kushteve të lëvizjes për përdoruesin e mjeteve me aftësi të kufizuar nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të rrampave, mirëmbajtjen sinjalistikës.
Nevoja për përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen me biçikleta si dhe promovimi i pedalimit.
Problemet e paraqitura:
Dëmtime të sinjalistikës nga persona të papërgjegjshëm si dhe nga aksidentet rrugore.
Përmirësimi të kapaciteteve teknike për zgjerimin e shërbimit të sinjalistikës edhe në në Njësitë Administrative.
Gjatë vitit 2025 kanë qenë në funksion dy nyje semaforësh në sheshin Parrucë dhe sheshin "Nënë Tereza". Këto dy nyje semaforësh kanë bërë të mundur një përmirësim të ndjeshëm të lëvizshmërisë së këmbësorëve, bicikletave dhe mjeteve motorike duke patur më shumë rrjedhshmëri në qarkullim.
Nisur nga kjo është vlerësuar e nevojshme shtimi i nyjeve të semaforëve në sheshe e rrugë të tjera për përmirësimin e lëvizshmërisë dhe rritjen e sigurisë për përdoruesit e rrugës nga këmbësorët dhe përdoruesit e mjeteve.

ii. Synimi i projektit

Përmirësimi i cilësisë të jetesës së qytetarëve dhe rritjen e sigurisë për përdoruesit e rrugës
Shtimi i semaforëve në sheshe e rrugë të tjera për përmirësimin e lëvizshmërisë dhe rritjen e sigurisë.
Shtim të korsive të dedikuara për bicikleta ,përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës për rritjen e sigurisë për përdoruesit e biçikletave
Implementimi i planit të mobilitetit së lëvishmërisë urbane dhe strategjise së parkingut për Bashkinë Shkodër.
Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedaluesit përmes shërbimeve të mirëmbajtjes dhe investimeve.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Viti 2026
Rritja e sigurisë në rrugë dhe lehtësisë së lëvizjes së qytetarëve.
Përmirësimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale për këmbësorët në të gjithë qytetin dhe Njësitë Administrative në përputhje me planin e mobilitetit të Bashkisë.
Përmirësimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale me qëllim rritjen e sigurisë në qarkullim në afërsi të shkollave.
Përmirësimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale për këmbësorët, invalidët dhe qarkullimin e mjeteve. Shtimi i korsive të dedikuara për lëvizjen me biciklela dhe mirëmbajtja e linjave ekzistuese të pedalimit. Në zbatim të planit të mobilitetit të bëhet plotësimi me sinjalistikë horizontale dhe vertikale të rrugëve.
Projekt idea:
Rritja e sigurisë në rrugë dhe lehtësisë së lëvizjes së qytetarëve.
Vendosja e semaforëve në disa nyje me densitet më të madh qarkullimi me qëllim përmirësimin e lëvizshmërisë, rritjen e sigurisë për përdoruesit e rrugës nga këmbësorët dhe përdoruesit e mjeteve.
Ky investim do të ketë impakt tek qytetarët pasi do të rrisë sigurinë në qarkullim do të shkurtojë kohën e lëvizjes dhe do të ketë ndikim pozitiv në mjedis pasi nga reduktimi i kohës së qëndrimit të mjeteve në trafik ulet ndotja e ajrit. Ky projekt duhet të vazhdojë në të ardhmen në disa nyje ku ka probleme në rrjedhshmërinë e lëvizjes së mjeteve, por fillimisht është bërë një vlerësim për nyjet më problematike të cilat janë propozuar si më prioritare.
Për vitin 2026 bazuar në project idenë janë hartuar preventivat paraprak për tre nyje semaforike të vlerësuara si më prioritare si më poshtë:
Nyja semaforike "A" Rrugët lidhëse Bulevardi "Skënderbeu" (Kryqëzim Ish Dega)
Nyja semaforike "B" Rrugët lidhëse me sheshin "Demokracia"
Nyja semaforike "C" Rrugët lidhëse me sheshin "Bashlaj

Viti 2027- 2028
Vazhdimi i zbatimit të studimit të planit të mobilitetit.
Përmirësimi i sinjalistikës horizontale me bojra plastike të qëndrueshme në kohë në qytet dhe njësitë administrative

Shtimi i vendqëndrimit të biçikletave sipas një studimi të mirëfilltë të ndyshimeve të infrastruktures në rrugët e qytetit. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale në bashkëpunim me sektorin e policisë rrugore.							
b) Rezultatet që prisni							
Rritja e sigurisë në rrugë dhe në hapësirat publike. Kushte lehtësuese dhe nxitje për përdorimin e biçikletave si dhe vendqëndrimin e tyre. Demotivim për përdorimin e automjeteve private. Një qytet me ajër më të pastër, me njerëz më aktivë e më të shëndetshëm,si dhe më të sigurtë nga aksidentet.							
c) Aktorët e mundshëm		**d) Kontributet e mundshme në projekt**					
Drejtoria e Ndriçimit rrugor dhe sinjalistikës		Bashkia e Shkodrës					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1.	Blerje materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikës	**7,000**			7,000		
A.2	Blerje cilindra PVC për kufizim korsie të dedikuara për lëvizjen me bicikleta .						
A.3	F.V Kufizues shpejtësie (bumpe gome);	**5,000**					5,000
A.4	Ndërtim nyje semaforike -Zbatim -Projektim -Mbikqyrje -Kolaudim						
Shuma		**12,000**			**7,000**		**5,000**
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1	Levizshmëria dhe sinjalistika	12,000			7,000		5,000
Shuma		**12,000**			**7,000**		**5,000**
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1	Levizshmëria dhe sinjalistika	12,000			7,000		5,000
Shuma		**12,000**			**7,000**		**5,000**
f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr. 14	**P.AE141.Q3.O1.A4.** Rivlerësimi, Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër	**Programi AE141**. Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Qyteti Shkodër, Njësia Administrative Velipojë, Njësia Administrative Rrethina, Njësia Administrative Ana e Malit, Njësia Administrative Njësia Administrative, Njësia Administrative Dajç ka sistem adresash të miratuar. Pjesa e mbetur e Njësive Administrative nuk disponon sistem adresash të miratuar.
Për qytetin dhe njësitë e përmendura, është realizuar azhornimi i objekteve të reja të ndërtuara në vitet e fundit.
Bashkia Shkodër aktualisht po përditëson sistemin hartografik elektronik të informacionit bazuar mbi verifikimin në territor.
Në qytetin e Shkodrës janë të plotësuara pjesa më e madhe e rrugëve me sinjalistikë treguese me emërtimin e rrugëve dhe shesheve sipas tabelave të vendusura sipas standarteve.
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike nëpërmjet punonjësve të Drejtorisë Ndriçimit rrugor dhe Sinjalistikës, gjatë vitit 2025 ka kryer shërbime të mirëmbajtjes së sinjalistikës treguese në funksion të sistemit të adresave në rrugë e sheshe publike të qytetit.

ii. Synimi i projektit

Plotësimi me sistem adresash Njësive Administrative që nuk disponon sistem adresash të miratuar
Përmirësimi i sistemit të adresave në qytet dhe Njësitë Administrative.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Mbledhja e të dhënave të gjëndjes ekzistuese të tyre në gjithë territorin
Rivlersimi i sistemeve të adresave ekzistuese
Mirëmbajtja dhe azhornimi i sitemit të adresave
Furnizimi dhe vendosja e tabelave të rrugëve të emërtuara rishtazi

b) Rezultatet që prisni

Funksionimi si një i vetëm i sistemeit të adresave në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
Furnizimi dhe vendosja e tabelave të rrugëve të emërtuara rishtazi
Mirëmbajtjae sitemit të adresave ekzistues

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Ndriçimit rrugor dhe sinjalistikës	Bashkia e Shkodrës

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1.	F.V. e tabelave për sistemin e adresave						
	Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1	F.V. e tabelave për sistemin e adresave						
Shuma							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1	F.V. e tabelave për sistemin e adresave						
Shuma							

f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 15	**P.AE141.Q4.O1.A1.** Shërbimi i Stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit	**Programi AE141**. Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Paga dhe shtesat mbi paga
Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të VKM nr. 113 dt.01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" ,VKM nr. 326 dt. 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, VKM nr.503 date 01.08.2024 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore
Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.
Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve
Paga, Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

b) Rezultatete pritshme

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.
Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Bashkia Shkoder

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026		Total (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	**26,970**	26,970				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	**4,277**		4,277			
A.3.	Dieta për punonjësit	**33**			33		
Shuma		**31,280**	**26,970**	**4,277**	**33**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**26,970**	26,970				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**4,277**		4,277			
A.3	Dieta për punonjësit	**33**			33		
Shuma		**31,280**	**26,970**	**4,277**	**33**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**28,341**	28,341				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**4,532**		4,532			
A.3	Dieta për punonjësit	**33**			33		
Shuma		**32,906**	**28,341**	**4,532**	**33**		

f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Sektori Ekonomik Financiar **Institucioni likujdues**: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 16	**P.AE141.Q4.O2.A1:** Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit	**Programi AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Në shërbim të drejtorisë së shërbimeve dhe monitorimit jane tre mjete transporti.
Mjetet në funksion kanë nevojë vazhdimisht për shërbime mirëmbajtje, furnizim me karburant, shërbimin e kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracioneve gjatë vitit.

ii. Synimi i projektit

Mjete transporti funksionale, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të punonjësve te NSHPP sipas nevojave që ato kanë.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Vlerësimi i gjendjes teknike të mjeteve të transportit në serviset e liçensuara dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të riparohen dhe të kthehen apo të mbahen në gjendje pune, si dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të nxirren jashtë përdorimit nga komisioni (proces në vazhdim)
Identifikimi i nevojave për karburant, pjesë këmbimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtyre automjeteve.
Përgatitja e preventivave dhe dokumentacioneve përkatëse të nevojshme për prokurim.
Zbatimi i procedurave të prokurimit sipas specifikimeve teknike të paracaktuara dhe monitorimi
Blerje karburanti
Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit
Siguracioni i automjeteve
Taksa qarkullimi, kolaudimi
Marrja në dorëzim dhe magazinimi i mallrave apo shërbimeve

b) Rezultatet e pritshme

Mjete transporti në gjendje të mirë pune në gatishmëri më të lartë për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme sipas nevojave.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2026		Totali (000 lekë)	Nga kjo :			
			Paga.sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje karburanti	**3,305**		3,305		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit	**422**		422		
A.3	Shpenzime për sigurimin e automjeteve	**50**		50		
A.4	Shpenzimi i taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**48**		48		
Shuma		**3,825**		**3,825**		

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2027		Totali (000 lekë)	Nga kjo :			
			Paga.sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje karburanti	**3,305**		3,305		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit	**422**		422		
A.3	Shpenzime për sigurimin e automjeteve	**50**		50		
A.4	Shpenzimi i taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**48**		48		
Shuma		**3,825**		**3,825**		

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2028		Totali (000 lekë)	Nga kjo :			
			Paga.sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje karburanti	**3,305**		3,305		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit	**422**		422		
A.3	Shpenzime për sigurimin e automjeteve	**50**		50		
A.4	Shpenzimi i taksave të qarkullimit dhe kolaudimi i automjeteve	**48**		48		
Shuma		**3,825**		**3,825**		

f) Periudha e zbatimit Janar 2026- Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr.17	**P.AE141.Q4.O2.A2** Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane	**Programi AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Menaxhimi i mbetjeve urbane është një nga shërbimet kryesore dhe me ndjeshmërine më të lartë si nga ana e qytetarëve ashtu edhe për Bashkinë Shkodër.
Për këtë Bashkia Shkodër ka në qendër të vemendjes së saj administrimin dhe menaxhimin e shërbimit të pastrimit në qytetin e Shkodrës dhe në 8 njësi administrative.
Gjithashtu, për të arritur rezultate në përmirësimin e zbatimit të ligjit janë përdorur instrumentët inovatorë si:
Bashkia Shkodër ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta urbane me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.35 datë 26.10.2024.
Drejtoria e Sherbimeve dhe Monitorimit ka të miratuar Procedurën standarde të administrimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, e cila funksionon si rregullore e brëndshme e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
Bashkia Shkodër, për përcaktimin e Kostos të menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimit të pastrimit zbaton VKM 319/2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve". Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së përformancës dhe standartit të shërbimit, përmes përmirësimit teknologjik, rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe vendosjes së penaliteteve në kontratat e shërbimit.
II. Përshkrim i shkurtër i shërbimit që ofrohet në vitin 2026

Shërbimi/ Zona	Qëndrore
Afati kontraktual	28.04.2026
Burimet njerëzore	83 punonjës
Mjetet	7 mjete plus nje mjet rezervë
Frekuenca e pastrimit	Cdo ditë, qëndra dy herë në ditë.

Sherbimi i pastrimit zona qendrore realizohet me sipermarrje private, draft marreveshja aktuale mbyllet me date 28.04.2026.
Shërbimi përfshin:
Grumbullim dhe transportin e mbetjeve bashkiake në të gjithë territorin e qytetit;
Frekuenca e parë shërbimit realizohet 1 herë në ditë/7 ditë të javës në të gjithë Qytetin gjatë orëve të natës;
Frekuenca e dytë e shërbimit realizohet 2 herë në ditë/7 ditë të javës ne 33% të pikave të grumbullimit të Qytetit në orët e ditës.
Mjetet që janë në përdorim janë: 4 mjete teknologjike me kapacitet 10 ton (+1 rezerve), 1 mjet kamioncin, 1 autobot uji, 1 autofshese.
Numri i kontenierëve në funksion të shërbimit, është 625 copë konteinerë, në zonën funksionale Qytet: të shpërndarë sipas hartës të miratuar për pikat e grumbullimit .
Frekuenca e lëvizjes së mjeteve dhe itineraret (sipas hartave më poshtë):







Kostoja e shërbimit mbulohet nga të ardhurat nga tarifa si më poshtë:

1. Te ardhura te planifikuara nga familjet: 100,081 leke
2. Te ardhura te planifikuara nga biznesi: 106,100 leke
3. Te ardhura te planifikuara nga institucionet: 464 leke,

TOTALI 206,645 leke

Kostoja e plotë e shërbimit mbulohet 206,645 lekë nga të ardhurat nga tarifa, ose 59.2 %,
Transferte specifike per mbetje urbane akorduar nga qeveria 4.4% dhe Subvencionim nga Bashkia 36.4%.
Ulja e mbulimit të kostos ka ardhur për shkak të efektit te rritjes se cmimit të depozitimit në lendfillin e Bushatit dhe pagat e fuqisë punëtore, me rritjen e minimumit të pagave me vendim qeverie.
Bashkia planifikon mbulimin e Kostos si ne tabelen me poshte:

Totali i mbulimit të kostos nga tarifat (LEKË/vit)	206,645	59.2%
Transferte specifike per mbetje urbane akorduar nga qeveria	15,300	4,4 %
Subvencionim nga Bashkia (LEKË/vit)	127,023	36,4%
Totali I buxhetit per sherbimin e pastrimit	**348,968**	**100%**



[1]*Te dhenat I jane referuar planifikimit te te ardhurave per vitet 2026-2028*

ii. Synimi i projektit

Zgjerimi i shërbimit në territor;
Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
Përdorimi me efiçiencë i burimeve financiare;
Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe tëbizneseve;
Shtim i pikave të grumbullimit;
Shtim i kontenierëve;
Përmirësimi I cilësisë së fshirjes së rrugëve
Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;
Ndërtimi i platformave përvendosjen e kontenierëve për një shërbim më të mirë, dhe për me shumë siguri.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit
Vijimi i sherbimit te pastrimit me sipermarrje private. Aplikimi i sistemit të adminstrimit dhe monitorimit i automatizuar, dhe transparent. Marrje e masave për përgatitjen e sezonit turistik. Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit. Studim dhe vlerësim i procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në zona pilot të qytetit. Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim. Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për reduktimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve të ricikluesshme. Shtimi i pikave të grumbullimit Hartimi i rregullores për marëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit. Eliminimi i mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private. Vazhdimi depozitimit te mbetjeve urbane ne landfillin Bushat. Ne kuadër të përmisimit te performancës së shërbimit tëfunksionojë sistemi i monitorimit. Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit.
b) Rezultatet që prisni
Shërbim me parametra të përmiresuar për të gjithë territorin. Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve. Studim dhe vlerësim për procesin e diferencimit të mbetjeve urbane në burim. Ofrimi i shërbimit ne orare tëpërcaktuara sipas një grafiku paraprak. Interesim i biznesit per fillimin e procesit te riciklimit. Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve. Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit. Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin Bushat dhe reduktimi i vend depozitimeve të pamiratuara. Përmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme**
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnëpër të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit të Bashkisë Shkodër Komuniteti dhe Bizneset Banorët e qytetit të Shkodrës	Bashkia Shkodër

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zona urbane për Bashkinë Shkodër zona Qytet	**100,000**			100,000		
B Investime						
B.1 Blerje kazanësh	**3,000**					3,000
B.2 Ndertim xhepa per konteniere (investim, mbikqyrje, kolaudim, etj)	**3,849**					3,849
Shuma	**106,849**			**100,000**		**6,849**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zona urbane për Bashkinë Shkodër zona Qytet	**100,000**			100,000		
B Investime						
B.1 Blerje kazanësh	**3,000**					3,000
B.2 Ndertim xhepa per konteniere (investim, mbikqyrje, kolaudim, etj)	**3,849**					3,849
Shuma	**106,849**			**100,000**		**6,849**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale

A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zona urbane për Bashkinë Shkodër zona Qytet	**100,000**			100,000		
B Investime						
B.1 Blerje kazanësh	**3,000**					3,000
B.2 Ndertim xhepa per konteniere (investim, mbikqyrje, kolaudim, etj)	**3,849**					3,849
Shuma	**106,849**			**100,000**		**6,849**
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike				

Nr.18	**P.AE141.Q4.O2.A3** Minimizimi i volumeve te mbetjeve te gjelberta dhe permirësimi i cilësisë të shërbimit të pastrimit në zonën Qytet	**Programi AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i.Situata

Aktualisht në Shqipëri nuk zbatohet grumbullimi i veçantë i mbetjeve biologjike. Kërkesat për administrimin e mbetjeve biologjike përcaktohen me VKM nr. 608, datë 17.9.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet e reduktimit të tyre", që konsiston në procedurat për mbledhjen, trajtimin dhe objektivat e lidhura me tarifa të veçanta. Objektivat e vendosura në VKM kërkojnë që grumbullimi i veçantë të bëhet në të gjitha bashkitë deri në vitin 2018, duke kërkuar që planet bashkiake të përcaktojnë një skemë gjithëpërfshirëse të grumbullimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve biologjike në nivel bashkie. Akti ligjor përcakton që bashkitë duhet të ulin sasinë e mbetjeve bio që shkojnë në landfill me 50% të mbetjeve totale të gjeneruara në vitin 2014, deri në vitin 2021 dhe në 35% të të njëjtit vit objektiv deri në vitin 2026. Aktualisht nuk ka ndarje në burim dhe për këtë arsye të gjitha mbetjet biologjike dërgohen në vendgrumbullime ose grumbullohen në hotspote.
Siç përcaktohet në Ligjin Organik, Ligjin Sektorial dhe aktet nënligjore sektoriale përkatëse, Bashkia e Shkodrës ka detyrimin të arrijë qëllimet e përcaktuara në mënyrë të pavarur. Për të qenë në përputhje me dispozitat legjislative, çdo bashki duhet të hartojë dhe miratojë një Plan për Menaxhimin e Mbetjeve në përputhje me Planet Rajonale dhe Kombëtare. Në këtë drejtim, Shkodra miratoi planin local të menaxhimit të mbetjve 2024-2029.
Përsa i përket kompostimit, Plani lokal për menaxhimin e mbetjeve 2024-2029, parashikon ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve si prioritete për Bashkinë.
Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është se pothuajse 10 njësi administrative (NjA) të Bashkisë Shkodër, duke përjashtuar qytetin urban të Shkodrës, janë periferike dhe kryesisht rurale. Sasia e konsiderueshme e mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, bujqësia dhe blegtoria në këto zona, ofron një mundësi të konsiderueshme si për iniciativat e kompostimit familjar (individual) ashtu edhe kolektiv. Vetë Shkodra, edhe pse ka karakter urban, ka në territorin e qytetit një numër të konsiderueshëm shtëpish private me oborre të pasura me pemë. Si një proces normal mirëmbajtjeje, krasitjet ndodhin dy herë në vit nga pronarët e këtyre oborreve, të cilët e çojnë materialin në koshat e mbetjeve publike, duke shkaktuar një ngarkesë të konsiderueshme në shërbime.Operatori sipërmarrës që ka për detyrë mirmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet gjeneron një volum të konsiderueshëm mbetje të gjelbërta, objekt këto të trajtimit me procesin e kompostimit në fushën e kompostimit që propozojmë.

ii. Synimi i projektit

GIZ ka suportuar Bashkinë Shkodër në realizimin e një studimi fizibiliteti për këtë rast.
Ky studim parafizibiliteti synon të justifikojë një projekt investimi për ndërtimin e një objekti për kompostimin e mbetjeve të gjelbra të grumbulluara veçmas nga parqet, mirëmbajtja e rrugëve dhe zona të tjera publike në Bashkinë e Shkodrës.
Qëllimi kryesor i investimit të propozuar është të zvogëlojë volumin e mbetjeve bashkiake të dërguara në landfille, duke kontribuar në këtë mënyrë në arritjen e objektivave kombëtare të mbetjeve biologjike të përcaktuara nga Strategjia Shqiptare e Mbetjeve 2020-2035.
Studimi paraprak i fizibilitetit synon:
• të japë një analizë të shkurtër të situatës së menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër;
• të vlerësojë sasinë e mbetjeve të gjelbra në komuna të krijuara nga burime të ndryshme;
• të ofrojë një pasqyrë të shkurtër të proceseve të kompostimit të mbetjeve të gjelbra;
• të propozojë investime prioritare afatshkurtra në kuadër të projektit aktual "BE për ekonomi qarkore dhe ekonomi qarkore për zhvillim të qëndrueshëm urban";
• të përcaktojë kërkesat minimale për vendin e kompostimit duke marrë parasysh kapacitetin e kërkuar dhe vendndodhjet alternative të propozuara nga bashkia e Shkodrës;
• të vlerësojë kostot e investimit dhe operimit në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e vendit të kompostimit.
Dokumenti do të shërbejë si bazë për përgatitjen e mëtejshme të projektit të investimit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit midis Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Bashkisë Shkodër me Nr.5055Prot datë 07.03.2024, Bashkia Shkodër në zbatim të projektit Ekonomia Qarkulluese dhe qytete të jetueshme nga tre opsione terrene në dispozicion për ndërtimin e fushës të kompostimit të mbetjeve të gjelbërta, u përzgjodh hapësira në rrenc pranë strehëzës të qenve, ku do të ndërmerren hapat e nevojshme ligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi për përcaktimin e fushës të përdorimti në këtë rast.
Pas analizimit të shpejtë të vendndodhjes, aksesit, hapësirës dhe distancës nga zonat e ndjeshme mjedisore, u konkludua se vendodhja e propozuar plotësojnë kushtet paraprake për ndërtimin e objektit të planifikuar të kompostimit dhe lejojnë zgjerimin e ardhshëm. GIZ Albania do të ralizoje përvec studimit të fizibilitetit edhe projekt ndërtimin së bashku me studimet përkatëse.

Cfarë synohet ?
Projekti synon si fillim grumbullimin e të gjitha mbetjeve të gjelbërta që dalin nga parqet dhe kopshtet publike si edhe ato që gjenerohen nga shtëpiat private në zonën urbane qytet. Me pas zona e shërbimit do të zgjerohet edh në zonat rurale, gjithmonë në zbatim të planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 2024-2029.
Shërbimet e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra publike janë pjesë e shërbimeve publike të përgjithshme në Bashkinë Shkodër. Ky shërbim është kontraktuar që në vitin 2021 me një kompani private. Në territorin e Bashkisë Shkodër (qyteti Shkodër dhe Njësia Administrative Velipojë) mirëmbahen gjithsej 161,348 m2 sipërfaqe të gjelbëruara publike. Shërbime të tjera të zonave të gjelbra përfshijnë krasitjen e pemëve dhe shkurreve dekorative brenda zonave të gjelbra dhe përgjatë rrugëve që përbëjnë rreth 11,800 pemë.
Bazuar në të dhënat për sipërfaqen e zonave të gjelbra dhe vegjetacionin e raportuar nga Bashkia, ne kemi përcaktuar sasinë duke përdorur informacionin e bazuar në njohuri, mbetjet e mundshme të krijuara nga aktivitetet e mirëmbajtjes, prandaj sasia totale e mbetjeve të gjelbra që parashikohet të krijohet nga hapësirat publike për qytetin e Shkoder dhe AU Velipoja eshte 3757 tn/vit. Kjo sasi gjenerohet kryesisht në qytetin e Shkodrës prej rreth 3140 tn/vit. Sasia totale e mbetjeve të gjelbra të menaxhuara aktualisht nga operatori privat raportohet të jetë 2,094 tn/vit, rreth 56% nga parashikimi. Materiali i mbledhur nuk transferohet në landfill por raportohet se do të përpunohet më tej nga operatori privat jo në koordinim me Bashkinë dhe jo për qëllime kompostimi.
Më poshtë jepet një pasqyrë e detajuar e mbulimit, mirëmbajtjes dhe mbetjeve të gjeneruara (të projektuara) të sipërfaqeve të gjelbra për qytetin e Shkodrës dhe NjA Velipojë ku ofrohen shërbimet e gjelbërimit nga Bashkia.
Për qëllimet e këtij studimi, ne do të fokusohemi vetëm në materialin e prodhuar në qytetin e Shkodrës, i cili zotëron potencialin për arritjen e objektivave brenda kostove të realizueshme për investime dhe funksionim.

b) Rezultatet që prisni

Për shërbimin e pastrimit të qytetit
Studimi I fizibilitetit ka llogaritur edhe projeksionin e gjenerimit të mbetjeve të gjelbërta nga viti 2024 deri ne vitin 2035.

Viti	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035
Mbetje të gjelbërta (parqe)	3,140	3,171	3,203	3,235	3,267	3,300	3,333	3,367	3,400	3,434	3,469	3,503
Mbetje të gjelbërta (kopshte private)	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427	2,427
Mbetje të gjelbërta total	5,567	5,598	5,630	5,662	5,694	5,727	5,760	5,794	5,827	5,861	5,896	5,930

OBJEKTIVI QË DO TË REALIZOHET ME TRAJTIMIN E MBETJEVE TË GJELBËRTA

VITI	2025	2030	2035
Target, % e mbetjeve të eleminuara nga depozitimi në landfill (të trajtuara në fushën e kompostimit)	35%	45%	55%
Mbetje të gjelbërta të gjeneruar (ton/vit) vetëm parqe	3,171	3333	3,503
Target, total i mbetjeve të gjelbërta të eleminuara nga depozitimi në lendfill (vetëm parqe) (të trajtuara në fushën e kompostimit)	1,110	1,500	1,927
Mbetje të gjelbërta të gjeneruara (ton/vit) parqe dhe kopshte private	5,589	5,760	5,930
Target, toali i mbetjeve të gjelbërta të eleminuara nga depozitimi ne lendfill(kopshte private) (të trajtuara në fushën e kompostimit)	1,959	2,592	3,262

Tabela e mësipërme tregon se në fazën fillestare mund të ndërtohet një objekt me kapacitet për të trajtuar afërsisht 1,000 t/vit, me një potencial për shtrirje deri në 3,500 ton/vit në vitin 2035 për të arritur objektivat e përcaktuara.
Për qëllimet e këtij studimi, ne do të fokusohemi vetëm në materialin e prodhuar në qytetin e Shkodrës, i cili zotëron potencialin për arritjen e objektivave brenda kostove të realizueshme për investime dhe funksionim.Më pas do të studiohet mundësia e zgjerimit të zonës të shërbimit.

c) Aktorët e mundshëm		**d) Kontributet e mundshme**
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnëpër të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit të Bashkisë Shkodër Komuniteti dhe Bizneset Banorët e qytetit të Shkodrës		Bashkia Shkodër
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali	Nga kjo:

	(mije lekë)	Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A Investime						
A1 Investim në fushën e kompostimit të mbetjeve të gjelbërta						
Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A Funksioni i fushës të kompostimit të mbeteve të gjelbërta						
A1. Vihet në funksion fusha e kompostimit të mbetjeve të gjelbërta						
Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A Funksioni i fushës të kompostimit të mbeteve të gjelbërta						
A1. Vihet në funksion fusha e kompostimit të mbetjeve të gjelbërta						
Shuma						
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni likuidues: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr.19	**P.AE141.Q4.O2.A4** **REUSEFUL**– Promovimi i reduktimit të mbetjeve përmes qendrave të ripërdorimit në zonën e Adriatikut të Jugut	**Programi AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i.Situata

Projekti: "Promovimi i reduktimit të mbetjeve përmes qendrave të ripërdorimit në zonën e Adriatikut të Jugut (REUSEFUL)", me partner lider Komuna Ostuni (Itali), është përzgjedhur për financim në kuadër të Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA III) Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027 (Itali-Shqipëri-Mali I Zi) bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt synon të krijojë qendra ripërdorimi në zonat e projektit, përfshirë Shkodrën, për mbledhjen, riparimin dhe shpërndarjen e pajisjeve, mobilieve dhe produkteve të tjera. Këto qendra zgjasin ciklin e jetës së produkteve, duke ndihmuar në uljen e volumit të mbetjeve, kursimin e kostove të menaxhimit të tyre dhe mbështetjen e shtresave me të ardhura më të ulëta, të cilat do të përfitojnë nga mallrat e dorës së dytë.

Programi synon të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar për zhvillim të zgjuar dhe të qëndrueshëm të territoreve të përfshira, me qëllim para-anëtarësimin e Shqipërisë dhe Malit të Zi në Bashkimin Evropian. Projekti REUSEFUL përputhet me Objektivin Specifik 2.2 të programit, duke synuar konkretisht mbrojtjen e biodiversitetit dhe uljen e ndotjes në zonat bregdetare dhe të mbrojtura të përfaqësuara nga territoret e partnerëve të projektit.

Anëtarët e projektit, Komuna Ostuni (Partner Lider), Komuna Trivento, Bashkia Shkodër dhe Komuna Ulqin kanë përvojë afatgjatë në projekte të ngjashme, të zbatuara në Shqipëri dhe Evropë. Anëtarët e konceptuan këtë projekt në mënyrë specifike bazuar në faktin se ekonomia qarkulluese kërkon jo vetëm iniciativa lokale e kombëtare, por edhe strategji të integruara ndërkufitare për bashkëpunim mes rajoneve me përvoja e burime të ndryshme. Shqipëria dhe Mali i Zi ende nuk kanë infrastrukturë për qendrat e ripërdorimit, ndërsa partnerët italianë me përvojë në këtë fushë mund të transferojnë njohuri e praktika të mira, duke përshpejtuar zhvillimin në rajon.

Grupet e interesit përfshijnë autoritetet vendore, rajonale e kombëtare, ofruesit e shërbimeve publike, organizatat joqeveritare, ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe publikun e gjerë. Autoritetet përfitojnë nga strategjia "zero mbetje" dhe shkëmbimi i praktikave të mira, institucionet kombëtare integrojnë rezultatet në politikat publike, ndërsa ofruesit e shërbimeve ulin kostot dhe rrisin efikasitetin. OJQ-të e mjedisit dhe përfshirjes sociale do të angazhohen në fushata sensibilizuese dhe shpërndarjen e produkteve për grupet vulnerabël. Bizneset e vogla, veçanërisht në sektorin e riparimeve, përfitojnë nga rritja e kërkesës për shërbime dhe produkte të përdorura, duke gjeneruar të ardhura të reja. Publiku i gjerë do të ketë akses në mallra me kosto të ulët dhe do të inkurajohet drejt konsumit të përgjegjshëm, duke kontribuar në uljen e mbetjeve dhe në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme.

Kuadri ligjor:

- Ligji 139/2015, "Për Vetëqeversjen Vendore";
- Vendimi Zbatues i Komisionit C(2022) 6940 i datës 26/09/2022 që miratimin e Programit Interreg IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor);
- "Thirrja për Propozime Projektesh për Projekte Standarde" e miratuar nga Komiteti i Monitorimit më 18/03/2024 dhe e botuar në Buletinin Zyrtar të Rajonit të Pulias (BURP) nr. 46 të datës 06/06/2024, dhe Formulari i Aplikimit i miratuar për Projekte Standarde;
- Marrëveshja e partneritetit me datë 20.08.2025 ndërmjet Komunës Ostuni si partner lider dhe Komunës Trivento, Bashkisë Shkodër dhe Komunës Ulqin si partnerë.

Buxheti i Projektit:

Buxheti total i projektit është 90,872,387 Lekë, nga të cilat financimi i Bashkimit Evropian do të jetë në masën 80-85% të kostove të pranueshme në vlerën 74,888,823.8 Lekë. Buxheti I dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 28,269,658 Lekë nga të cilat 85% në vlerën 24,029,209 Lekë do të financohen nga donatori dhe 15% do të jetë bashkëfinancim i Bashkisë Shkodër me vlerë 4,240,449 lekë.

Vlera e TVSH-së është shpenzim që nuk mbulohet me fondet e Bashkimit Evropian. Bashkëfinancimi me fondet e veta për shpenzimet e TVSH-së, me vlerë 4,290,066 lekë do të alokohet në programin AE141: Shërbimet Publike Vendore, nga të cilat 508,272.8 lekë për shpenzime operative dhe 3,781,793.2 lekë për shpenzime kapitale të trupëzuara.

Kohëzgjatja e projektit është 30 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës nga të gjitha palët.

ii. Synimi i projektit

REUSEFUL synon të adresojë sfidat që lidhen me ndotjen e shkaktuar nga prodhimi i mbeturinave në komunitete me rëndësi të lartë mjedisore, përmes zhvillimit të qendrave të ripërdorimit, me qëllim zgjatjen e ciklit jetësor të mallrave dhe uljen e konsumit dhe asgjësimit të këtyre burimeve. Objektivi është të promovohet ripërdorimi dhe qëndrueshmëria, duke kontribuar në uljen e rrjedhave të mbeturinave dhe ndikimin mjedisor që lidhet me to në biodiversitet, në përputhje me direktivën e BE-së për menaxhimin e mbeturinave.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Logjika e ndërhyrjes nëpërmjet aktiviteteve: Në vijim të kontekstit të ndërhyrjes, projekti do të zbatohet nëpërmjet 3 Linjave të Punës (LP) të ndërlidhura. Linjat e Punës janë:

LP1: STUDIME PËRGATITORE DHE FUSHATË NDËRGJEGJËSIMI

LP2: ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I ZGJIDHJEVE TË PËRBASHKËTA

LP3: PLAN VEPRIMI NDËRKUFITAR PËR ZGJIDHJE "0 MBETJE"

b) Rezultatet që prisni

Rezultatet e aktiviteteve pritet të jenë:

• Një Qendër Ripërdorimi në Shkodër;

• Zhvillimi i Strategjisë së Përbashkë „0 Mbetje";

• Reduktim i volumit të mbetjeve që hidhen në landfill;

• Komunitet i informuar dhe i ndërgjegjësuar për rëndësinë e ekonomisë qarkulluese dhe ripërdorimit.						
c) Aktorët e mundshëm		**d) Kontributet e mundshme**				
▪ Autoritetet vendore; ▪ Organizatat e shoqërisë civile; ▪ Autoriteti për menaxhimin e mbetjeve; Komuniteti në përgjithësi.		Partnerë ne projekt: 1. Bashkia Shkodër (Shqipëri) 2. Komuna Ostuni (Itali) 3. Komuna Trivento (Itali) 4. Komuna Ulqin (Mali I Zi)				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurim e	Operativ	Tran sfer	Kapitale
A.1 Stafi i projektit **(bashkëfinancim)**	**1,805,112**					1,805,112
A.2 Shpenzime për udhëtim dhe akomodim (donatori)	**24,196**			24,196		
A.3 Shërbim Ekspertizë e jashtme – Mbështetje teknike për menaxhimin e projektit (donatori)	**583,020**			583,020		
A.4 Shërbim Ekspertizë e jashtme – Studim analitik për menaxhimin e mbetjeve në Shkodër (donatori)	**145,755**			145,755		
A.5 Mbulim i vlerës TVSH për shpenzime operative **(fondet e bashkisë)**	**4,839**					4,839
Totali 2026	**2,562,922**			**752,971**		**1,809,951**
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurim e	Operativ	Tran sfer	Kapitale
A.1 Stafi i projektit **(bashkëfinancim)**	**1,805,112**					1,802,112
A.2 Shpenzime për udhëtim dhe akomodim (donatori)	**736,150**			736,150		
A.3 Shërbim Ekspertizë e jashtme – Mbështetje teknike për menaxhimin e projektit (donatori)	**583,020**			583,020		
A.4 Shërbim – fushatë ndërgjegjësuese dhe materiale promocionale (donatori)	**242,925**			242,925		
A.5 Organizim aktivitete dhe workshope (donatori)	**194,340**			194,340		
A.6 Ekspertizë e jashtme – menaxhimi i qendrës së ripërdorimit (donatori)	**194,340**			194,340		
A.7 Ekspertizë e jashtme – organizimi dhe hartimi i trajnimeve të përbashkëta (donatori)	**223,491**			223,491		
A.8 Ekspertizë e jashtme – Hartimi i strategjisë “0 Mbetje” (donatori)	**340,095**			340,095		
A.9 Organizimi i aktivitetit përmbyllës të projektit REUSEFUL (donatori)	**437,265**			437,265		
A.10 Blerje pajisje për qendrën e ripërdorimit (donatori)	**388,680**					388,680
A.11 Ndërtim i qendrës së ripërdorimit (donatori)	**18,240,286**					18,240,286
A.12 Mbikqyrje e qendrës së ripërdorimit (donatori)	**250,000**					250,000
A.13 Kolaudim i qendrës së ripërdorimit (donatori)	**30,000**					30,000
A.14 Mbulim i vlerës TVSH për ndertimin e qendres **(fondet e bashkisë)**	**3,781,793**					3,781,793
A.15 Mbulim i vlerës TVSH për shpenzime operative **(fondet e bashkisë)**	**501,452**					501,452
A.16 Shpenzime të tjera për projektin (donatori)	**673,087**			673,087		
Totali 2027	**28,622,036**			**3,624,713**		**24,997,323**
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurim e	Operativ	Tran sfer	Kapitale

A.1 Stafi i projektit **(bashkëfinancim)**	**178,947**					178,947
A.1.1 Stafi i projektit (donatori)	**246,798**	211,480	35,318			
Totali 2028	**425,745**	**211,480**	**35,318**			**178,947**
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit **Institucioni likuidues**: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr. 20	**P.AE141.Q4.O3.A1** Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Depozitimi i mbetjeve urbane të grumbulluara nga të treja zonat funksionale behet në Lendfillin e Bushatit.
Për zonën qëndrore realizohet nepermjet kontratës mes Bashkise Shkoder dhe Nderkumunales, ndërsa për njësitë administrative të zonës Perëndimore dhe Lindore me ane të operatorëve sipërmarrës.
Bashkia Shkodër përllogarit buxhetin që i nevojitet për të treja zonat, për të parën qytetin e menaxhon me anë të kontratës të drejt për drejtë me lednfillin ndërsa me dy zonat e tjera buxheti parashikohet në buxhetin vjetor duke e reflektuar në kontratat respektive me operatorët sipërmarrës të zonës Lindore dhe Perëndimore.
Bashkia Shkodër me datën 24.10.2024 ka marrë njoftim zyrtar për vendimarrjen e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha për rritjen e cmimit për shërbimin e depozitimit të mbetjeve urbane në vendgrumbullimin e mbetjeve në lendfilline Bushatit me 1695 lekë pa tvsh,vendim me Nr.14 datë 16.10.2024. Vlera e shërbimit për depozitimin për të treja zonat do të duhet të reflektohet në buxhetin e vitit pasardhës dhe të tre viteve të buxhetit afat mesëm 2026-2028.
Si më poshtë paraqitet parashikimi për vitin 2026 dhe atë afatmesëm.
Vlera e depozitimit të mbetjeve

Zonat Funksionale	Tonazhi /ton	Leke/pa tvsh	TOTALI /pa tvsh	Totali me tvsh
Qyteti	28,888	1,695	48,965,160	58,758,192
Lindore	7,050	1,695	11,949,750	14,339,700
Perendimore	7,356	1,695	12,468,420	14,962,104
TOTALI	43,294	1,695	73,383,330	88,059,996
		TVSH	14,676,666	
		Total me TVSH	88,059,996	

Shërbimi	Viti 2026 depozitimi/ vlera në lekë
Sherbimi i pastrimit zona qendrore	58,758,192
Shërbimi i pastrimit Zona perëndimore:	14,339,700.00
Shërbimi i pastrimit Zona lindore:	14,962,104.00
TOTALI	88,059,996

ii. Synimi i projektit

Zgjerimi i shërbimit në territor;
Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
Përdorimi me efiçiencë i burimeve financiare;
Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve;
Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Ndërmarrjen e iniciativave për zvoglimin e volumeve të mbetjeve që dorëzohen ne lendfilline Bushatit;
Studim dhe vlerësim i procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në zona pilot të qytetit.
Vijimi i sherbimit te dorëzimit të mbetjeve urbane në lendfilline Bushatit;
Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim.
Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për reduktimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve të ricikluesshme.
Zbatimi i rregullores për marëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit.
Ne kuadër të përmisimit te performancës së shërbimit tëfunksionojë sistemi i monitorimit.

b) Rezultatet që prisni

Shërbim me parametra të përmiresuar për të gjithë territorin.
Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve.
Studim dhe vlerësim për procesin e diferencimit të mbetjeve urbane në burim.
Ofrimi i shërbimit ne orare tëpërcaktuara sipas një grafiku paraprak.
Interesim i biznesit per fillimin e procesit te riciklimit.
Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve.
Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit.
Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin Bushat dhe reduktimi i vend depozitimeve të pamiratuara.
Përmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme**
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnë për të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin dhe njësite aministrative Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit dhe njësitë administrative	Bashkia Shkodër

Komuniteti dhe Bizneset						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve						
A1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Qëndrore.	58,758			58,758		
A2 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	13,241			13,241		
A2.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	1,721			1,721		
A.3. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	12,690			12,690		
A3.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	1,650			1,650		
Shuma	**88,060**			**88,060**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve						
A.1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Qëndrore.	58,758			58,758		
A2 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	13,241			13,241		
A2.1Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	1,721			1,721		
A.3. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	12,690			12,690		
A3.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	1,650			1,650		
Shuma	**88,060**			**88,060**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve						
A1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Qëndrore.	58,758			58,758		
A.2 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	13,241			13,241		
A2.1Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	1,721			1,721		
A.3. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	12,690			12,690		
A3.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	1,650			1,650		
Shuma	**88,060**			**88,060**		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likuidues**: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike				

Nr.20	**P.AE141.Q4.O4.A1-A2** Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Shërbimi i pastrimit ne Bashkine Shkodër ofrohet në 8 njësi administrative.
Bashkia Shkodër ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta urbane me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.35 datë 26.10.2024.
Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit ka të miratuar Procedurën standarde të administrimti të ofrimit të shërbimti të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, e cila funksionon si rregullore e brëndshme e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
Bashkia Shkodër, për përcaktimin e Kostos të menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimit të pastrimit zbaton VKM 319/2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve''.Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së përformancës dhe standartit të shërbimit, përmes përmirësimit teknologjik, rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe vendosjes së penaliteteve në kontratat e shërbimit.
II. Përshkrim i shkurtër i shërbimit që ofrohet në vitin 2026

Shërbimi/ Zona	Perëndimore	Lindore
Afati kontraktual	28.06.2026	18.10.2026
Burimet njerëzore	40 punonjës, 10 përgjatë gjithë vitit e 30 punonjës sezonal,	13 punonjës
Mjetet	2 mjete nga 10 ton përgjatë gjithe vitit dhe nje 1 mjet 10 ton e 1 mjet 5 ton rezerve.	2 mjete 10 ton, 1 mjet 7 ton dhe 1 mjet 10 ton rezervë.
Frekuenca e pastrimit	Dy herë në javë, përgjatë sezonit turistik, në Velipoje-Plazh është dy herë në ditë.	Tre herë në jave, Zona Theth nje-dy herë në javë.

Mbledhja dhe transporti i mbetjeve nga zonat rurale përfshin shërbimin e pastrimit në dy zonat funksionale në Zonën perëndimore me nj.a Bërdicë Ana e Malit Dajc dhe Velipojë dhe zona Lindore me nj.a Rrethina Postribë Shalë dhe Gur i Zi.
Shërbimi përfshin:
Grumbullim dhe transportin e mbetjeve bashkiake në të gjithë territorin e njësive administrative të këtyre zonave funksionale zonës Perëndimore dhe Lindore ;
Shërbimi i pastrimit Zona perëndimore: në këtë zonë përfshihen njësitë Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç.

ÇFARË SYNOJMË NË VITIN 2026
Duke marrë në konsideratë kërkesat për përmirësimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve në landfill, janë parashikuar kostot optimale që marrin në konsideratë:
Zgjerimin e shërbimit në territor;
Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
Përdorimin me efiçiencë të burimeve financiare;
Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve;
Shtim i pikave të grumbullimit;
Shtim i kontenierëve;
Përmirësimi I cilësisë së fshirjes së rrugëve
Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;
Ndërtimi i platformave përvendosjen e kontenierëve për një shërbim më të mirë, dhe për me shumë siguri.
Për realizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane janë llogaritur kostot e shërbimit për numrin e pikave të grumbullimit, numër kontenierësh, numër dhe lloji i mjeteve dhe transporti në landfill, sipas normës së gjenerimit të mbetjeve dhe frekuencës së shërbimit.

ii. Synimi i projektit

Zgjerimi i shërbimit në territor;
Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
Përdorimi me efiçiencë i burimeve financiare;
Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe tëbizneseve;
Shtim i pikave të grumbullimit;
Shtim i kontenierëve;
Përmirësimi I cilësisë së fshirjes së rrugëve
Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;
Ndërtimi i platformave përvendosjen e kontenierëve për një shërbim më të mirë, dhe për me shumë siguri.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit. Studim dhe vlerësim i procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në zona pilot të qytetit. Vijimi i sherbimit te pastrimit me sipermarrje private. Marrje e masave për përgatitjen e sezonit turistik. Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim. Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për reduktimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve të ricikluesshme. Shtimi i pikave të grumbullimit Hartimi i rregullores për marëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit. Eliminimi i mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private. Vazhdimi depozitimit te mbetjeve urbane ne landfillin Bushat. Ne kuadër të përmisimit te performancës së shërbimit tëfunksionojë sistemi i monitorimit. Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit.
b) Rezultatet që prisni
Shërbim me parametra të përmiresuar për të gjithë territorin. Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve. Studim dhe vlerësim për procesin e diferencimit të mbetjeve urbane në burim. Ofrimi i shërbimit ne orare tëpërcaktuara sipas një grafiku paraprak. Interesim i biznesit per fillimin e procesit te riciklimit. Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve. Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit. Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin Bushat dhe reduktimi i vend depozitimeve të pamiratuara. Përmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme**
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnëpër të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin dhe njësitministrative Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit dhe njësitë administrative të Bashkisë Shkodër Komuniteti dhe Bizneset Banorët e qytetit të Shkodrës	Bashkia Shkodër

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona “Lindore”	32,123			32,123		
A.2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona Perëndimore	39,269			39,269		
B. Investime						
B1 Blerje Kontenier						
B.2 Ndërtim xhepash per konteniere						
Shuma	**71,392**			**71,392**		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona “Lindore”	32,123			32,123		
A.2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona Perëndimore	39,269			39,269		
B. Investime						
B1 Blerje Kontenier						
B.2 Ndërtim xhepash per konteniere						
Shuma	**71,392**			**71,392**		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona “Lindore”	32,123			32,123		
A.2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona Perëndimore	39,269			39,269		
B. Investime						

B1 Blerje Kontenier						
B.2 Ndërtim xhepash per konteniere						
Shuma	**71,392**			**71,392**		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit**: Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr.22	**P.AE141.Q4.O5.A1** Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Me kontratat sipërmarrëse te shërbimit të pastrimit Bashkia Shkodër realizon edhe pastrimin e rrugëve manulaisht dhe me mjet teknologjik përfshirë ketu rrugë, sheshe dhe trotuarë ku është e lejuar. Këto shërbime realizohen me kontratën sipërmarrëse per qytetin dhe me plazhin e Velipojës gjatë sezonit turistik për fshirje të sheshit qendror dhe pedonales apo mirmbajtjen e tualeteve publikë.
Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve
Shërbimi i pastrimit me krahë
Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:
Fshirjen me punëtorë me fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj.
Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknollogjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.
Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknollogjike.
Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknollogjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.
Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.
Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit).
Plani i punës dhe grafikët e punimeve janë si më poshtë:
Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.
Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njërës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.
Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.
Rregulla për t'u zbatuar:
Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.
Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
Për raste të veçanta Kontraktori është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit,ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie, Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.
Kontraktori duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimet Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:
Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme.
Shërbimi i pastrimit të rrugëve me makineri teknologjike
Autoriteti kontrator ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar, sipas grafikeve perkates me frekuencat e percaktuara. Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknollogjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një sipërfaqe prej 40,000 m2 /ditë me frekuence 7 herë në javë. Këto janë parashikuar në grafikun e listën së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Qender dhe sipas hartës bashkëngjitur në kontratën e shërbimit.
Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:
Fshirjen me makina teknollogjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë sipas grafikut të percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.
Fshirjen e trotuareve dhe pedonaleve me makineri të vogël teknologjike, sipas grafikut të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve janë si më poshtë:
Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.
Fshirja me makineri teknollogjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër. Fshirja e trotuareve dhe pedonaleve me mjetin e vogël teknologjik, do të bëhet në oraret e dakortësuara me Autoritetin kontraktor.
Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Kontraktori nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standardeve të kërkuara, përdorimin e makinave teknollogjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.
Nuk lejohet fshirja e rrugës me makineri teknollogjike, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.
Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.
Për raste të veçanta Kontraktuesi është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

ii. Synimi i projektit

Përdorimi me efiçiencë i burimeve financiare;
Përmirësimi I cilësisë së fshirjes së rrugëve
Zgjerimi i shërbimit në territor;
Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Aplikimi i sistemit të adminstrimit dhe monitorimit i automatizuar, dhe transparent.
Vijimi i sherbimit te pastrimit me sipermarrje private.
Marrje e masave për përgatitjen e sezonit turistik.
Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit.
Zbatimi i rregullores për marëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit.
Ne kuadër të përmisimit te performancës së shërbimit tëfunksionojë sistemi i monitorimit.

b) Rezultatet që prisni

Shërbim me parametra të përmiresuar për të gjithë territorin.
Ofrimi i shërbimit ne orare tëpërcaktuara sipas një grafiku paraprak.
Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve.
Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit.
Përmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme**
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnëpër të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin dhe njësitministrative Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit dhe njësitë administrative të Bashkisë Shkodër Banorët e qytetit të Shkodrës	Bashkia Shkodër

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Siguri me	Operativ	Transfer	Kapitale
C. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve						
C1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve Bashkia Shkodër "Zona Qendrore"	43,004			43,004		
C2. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve Bashkia Shkodër "Zona Perëndimore"	1,996			1,996		
D Investime						
Shuma	**45,000**			**45,000**		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Nga kjo:				
		Paga	Siguri me	Operativ	Transfer	Kapitale
C. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve						
C1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve Bashkia Shkodër "Zona Qendrore"	43,004			43,004		
C2. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve Bashkia Shkodër "Zona Perëndimore"	1,996			1,996		
D Investime						
Shuma	**45,000**			**45,000**		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Nga kjo:				
		Paga	Siguri me	Operativ	Transfer	Kapitale
C. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve						
C1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve Bashkia Shkodër "Zona Qendrore"	43,004			43,004		
C2. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve Bashkia Shkodër "Zona Perëndimore"	1,996			1,996		

D Investime						
Shuma	**45,000**			**45,000**		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likuidues**: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike				

Nr.23	**P.AE141.Q5.O1.A1.** Paga dhe sigurime te stafit - Gjelbrim Varreza	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Paga dhe shtesat mbi paga
Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të VKM nr. 113 dt.01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" ,VKM nr. 326 dt. 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, VKM nr.503 date 01.08.2024 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore
Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.
Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve
Paga, Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

b) Rezultatete pritshme

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.
Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Bashkia Shkoder

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026		Total (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	**2,314**	2,314				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	**368**		368			
A.3.	Dieta për punonjësit	**4**			4		
Shuma		**2,686**	**2,314**	**368**	**4**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	2,314	2,314				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	368		368			
A.3	Dieta për punonjësit	4			4		
Shuma		**2,686**	**2,314**	**368**	**4**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	2,314	2,314				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	368		368			
A.3	Dieta për punonjësit	4			4		
Shuma		**2,686**	**2,314**	**368**	**4**		

f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Sektori Ekonomik Financiar **Institcioni likujdues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 24	**P.AE141.Q5.O2.A1.**Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrim i shkurtër i projektit

i. Situata

Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike realizohet me sipërmarrje në varrezat publike dhe varrezave të dëshmorëve. Shërbimet kryesore që do realizohen në mirëmbajtjen e territorit janë:
Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme ndërmjet parcelave
Mbjellje bordurë të gjelbërt në parcelat e reja
Mbjellje drurë dekorativ në parcelat e reja
Mbjellje shkurre dekorative në parcelat e reja
Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve.
Shërbimi i ruajtjes dhe mirëmbajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmorëve
Eshte realizuar investimi në sipërfaqen e mbetur të territorit të rrethuar për varreza publike në një sipërfaqe prej 10 000 m2 për ti paraprirë nevojave për varreza. Me kete investim siperfaqja e pergjitshme arrin ne 100 180 m2
Situata e Vlerësuar:
Shpesh ka vështirësi në administrimin të territorit sipas rregullores së funksionimit te varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë rrethim të plotë në pjesën e parcelave të vjetra. Kjo shkakton vështirësi në kontrollin e territorit dhe lëvizje të pakontrolluara të kalimtarëve dhe kafshëve.
Në Njësitë Administrative Bashkia Shkodër ka angazhuar punonjës të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave.
Në disa Njësi Administrative nevojitet zgjerim i sipërfaqeve të varrezave.
Nisur nga situatat e paraqitura vitet e kaluara që për disa persona që kanë humbur jetën nuk ka pasur të afërm që të marrin përsipër shërbimin e varrimit, shpenzimet për këto raste janë përballuar nga bashkia.
Domosdoshmëria për një studim për përcaktimin e një territori të ri për varreza publike dhe realizimi i investimit për ti paraprirë nevojave të një periudhe afatmesme.

ii. Synimi i projektit

Bashkëpunimi me komunitetin, institucionet e besimeve fetare për një mbarëvajte komunitare të këtij shërbimi në te gjithë territorin Ofrim i shërbimit publik të mirëmbajtjes të varrezave publike në 80 % të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër si dhe të varrezave të dëshmorëve
Ofrimit i shërbimit cilësor në cdo kohë të shërbimit të varrimit dhe mirëmbajtja e varrezave publike dhe të dëshmorëve në përputhje me pritshmërinë e komunigtetit .
Ofrimi i shërbimit në Njësite Administrative, përmes punonjësve publike.
Realizimi i procedurave per zgjerimin një territor te ri për ndërtim të varrezave publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese.
Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanë të afërm.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Administrim më i mirë i territorit nëpërmjet investimit për rrethimin e pjesëve të dëmtuara dhe ndricimit të territorit në bashkëpunim me operatorin sipërmarrës.
Mirëmbajtja e gjithë sipërfaqes përfshirë dhe sipërfaqen e parcelave të reja të cilat do të plotësojnë kërkesat për shërbime funerale.
Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanëpërkujdesje nga të afërm, ku përshihen arkivoli, veshmbathja dhe shpenzimet për shërbimin e varrimit.
Shtimi me 10 000 m2 i sipërfaqes së investuar në mirëmbajtje.
Përmirësim i shërbimit të varrezave publike në Bashkinë Shkodër.
Përmirësim i performancës së ofrimit të shërbimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rregullores.
Realizimi i procedurave për planifikim territori për ndërtimin e varreza publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese.
Realizimi i projektit dhe investimit për ndërtim të varrezave publike.
Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanë të afërm, ku përshihen arkivoli, veshmbathja dhe shpenzimet për shërbimin e varrimit.

b) Rezultatet që prisni

Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpermjët një sistemi më efikas të të monitorimit.
Zgjerim territori per varreza ne NJ.A
Ofrim i shërbimit me standarte për mirëmbajtjen e varrezave publike.
Garantimin e nevojave për vijimësinë e shërbimit dhe administrimit më të mirë të territorit.
Realizimi i studimit për sigurimin e një territori për ndërtim të varrezave publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese
Realizimi i projektit dhe planifikimi i investimit për ndërtim të varrezave publike.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit	Bashkia Shkoder

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe varrezat e dëshmorëve.	15,832			15,832		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
A.3	Ndertim parcela te reja dhe muri rrethues i varrezave publike FAZA II						
	Shuma	**16,632**			**16,632**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali	Nga kjo:				

		(mije lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe varrezat e dëshmorëve.	15,832			15,832		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
A.3	Ndërtim parcela të reja (investim, mbikqyrje, kolaudim, etj)						
	Shuma	**16,632**			**16,632**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe të dëshmorëve	15,832			15,832		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
A.3	Ndërtim parcela të reja (investim, mbikqyrje, kolaudim, etj)						
	Shuma	**16,632**			**16,632**		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit**: Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likuidues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr.25	**P.AE141.Q6.O1.A1.** Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

I. Situata

Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta realizohet me sipërmarrje private bazuar në në kontratën e shërbimit për mirëmbajtjen e 89,940 m^2 sipërfaqe të gjelbër, ku përfshihen 74 lulishte ndër të cilat 72,940 m^2 në qytet dhe 17,000 m^2 lulishte në Velipojë. Këto lulishte sipas rendësisë dhe sipërfaqeve përkatëse janë specifikuar sipas kategorive të sipërfaqeve të gjelbërta, tipi "A", "B", "C".

Sipërfaqe të gjelbra Tipi A (Intensive) - përfshihen lulishte dhe parqe Urbane, e kushtëzuar nga frekuentimi I lartë social.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi B (të rëndëshishme) – përfshihen zona të gjelbra të lagjeve, rrethrrotullime, dhe parqe lojrash.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi C (mirëmbajtje me frekuencë të reduktuar) – përfshijnë zona të gjelbërta me shërbim, me frekuenca të reduktuara sipas grafikut e mirëmbajtjes.

Janë kryer sipas grafikëve të përcaktuar në funksion të tipologjive dhe elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve në zërat e: mirëmbajtjes së siperfaqes së barit, drurëve dekorativë, bordurave të gjelbra, shkurreve, sipërfaqeve ujore, mirëmbajtjen dhe riparimin e stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj.

Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Shirokës duke barë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqia, pastrami I bregut të liqenit si dhe pjesës ujore në afërsi të bregut

Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Kalasë duke barë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqia.

Situata e vlerësuar:

Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve.

Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona të papërgjegjshëm, kryesisht në zonën Pedonale- Molo.

Ndotja e shatërvaneve dhe dëmtimet, shpesh nga papërgjegjëshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to dhe prishin aksesorët e shatërvanit.

Planifikimi i ndërhyrjes për riorganizimin e hapësirave të gjelbërta, duke u mbeshtetur ne kulturen dhe traditen e qytetit ne kultivimin e bimëve tradicionale.

Nevoja për rehabilitim te lulishteve ne zonat ku ka patur nderhyrje per lirimin e hapsirave publike:

Unaza Perëndimore – Zëvendësim me rrapa të mëdhenj.

Pema ekzistuese (Melia) prodhon sasi të konsiderueshme frutash, të cilat krijojnë ndotje vizuale dhe ndotje të mjedisit përreth. Rrënjët e këtyre pemëve janë problematike, pasi ngrihen në sipërfaqe dhe dëmtojnë trotuarin, duke krijuar pengesa për këmbësorët dhe kosto shtesë mirëmbajtjeje. Zëvendësimi me rrapa do të sigurojë një gjelbërim më serioz, jetëgjatë dhe të qëndrueshëm, si edhe një hije më efektive për zonën urbane.

Reabilitimi Rruga Cakej/ Lulishte e re te Spitalet

Ne kuadër te lirimit të hapësirave publike është menduar projektimi i një lulishte, e cila do të ofroje një mjedis më të sigurt dhe më të përshtatshëm për komunitetin. Përmirësim të cilësisë së ajrit dhe shtim të sipërfaqes së gjelbër.

ii. Synimi i projektit

Realizimi të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra, për të gjithë Bashkinë, me objektivin për të rritur sipërfaqe te gjelbërta në funksion dhe në përputhje me pritshmërinë e të qytetarëve.

Përmirësimi gjelbërimit rrugor, nëprmjet ndërhyrjeve sipas vlerësimit të specialistëve sipas tipologjise së drurëve.

Riorganizimi i sipërfaqeve të gjelbra në kuadër të përmisimit të peisazhit urban dhe historik, si dhe për të qënë funksional për të gjithë komunitetin si dhe duke prezantuar,sipas traditës dhe kulturës së qytetit, me bimësi si: lagerstroma, trëndafila, lule vjolë, kadife,ciklamin, salvia etj.

-Përmirësim të mëtejshëm të imazhit në lulishten e plazhit Velipojë në funksion të pushuesve vendas dhe të huaj.

Krijimi i sipërfaqeve të reja të gjelbra, të përfshira në projektet i investimeve për rikualifikim të zonave urbane.

Zgjerim i gjelbërimit rrugor në Nj.A, sipas prioriteteve.

Planifikimi për shërbimin në vitin 2026:

(lekë)

Mirëmbajtje e Sipërfaqe të gjelbra dhe ujore	42,500
Shpenzime operative	900
Investime	0
TOTAL	**43,400**

Mbulimi i kostove të shërbimit të gjelbërimit për vitin 2026 përllogaritet si më poshtë
Kostoja e shërbimit mbulohet nga të ardhurat nga tarifa si më poshtë:

1. Te ardhura te planifikuara nga familjet: 13,700 leke
2. Te ardhura te planifikuara nga biznesi: 15,100 leke
3. Te ardhura te planifikuara nga institucionet: 160 leke,

TOTALI **28,960 leke**

(lekë)

Totali i mbulimit të kostos nga tarifat (LEKË/vit)	28,960	67%
Transferte specifike te akorduar nga qeveria	0	0 %
Subvencionim nga Bashkia (LEKË/vit)	14,440	33%
Totali I buxhetit per sherbimin e gjelbrimit	**43,400**	**100%**



[2]*Te dhenat I jane referuar planifikimit te te ardhurave per vitet 2026-2028.*

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Rikualifikimi i lulishteve ekzistuese duke përmirësuar kushtet sipas pritshmërisë së qytetrëve.
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra ekzistuese me të gjitha elementët sipas kontratës me operatarin sipërmarës si dhe sipërfaqet e reja të nga investimet e Bashkisë Shkodër.
Do të kryhet mirëmbatja e gjelbrimit rrugor në rrugët ekzistues si dhe mirëmbatja e atyre të mbjella ne vitin paraardhes.
Rikualifikim të blloqeve të banimit si pjesë e investimeve nëpërmjet rikonstruksioneve të reja.
Vazhdim I përmirësim të dhe zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra në plazhin Velipojë dhe zona të tjera turistike.
Përmirësim i sistemit të monitorimit të shërbimit në kuadër të plotësimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara.
Rritje e i investimeve për gjelbërim rrugor në Nj.A.
Përmirësim i përformancës së ofrimit të shërbimit të gjelbërimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve.

b) Rezultatet që prisni

Shtim I sipërfaqeve të gjelbërimit dhe gjelbërimit rrugor.
Do të hartohet një plan i saktë veprimi për një periudhë afatmesme, i cili do të analizojë nevojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për përfomancën e ofrimit të shërbimit.
Ofrim i shërbimit të standartizuar për hapësirat e gjelbërta ekzisutese.
Rritje në përqindje dhe dendësi e sipërfaqeve të gjelbërta, funsionale në shërbim të qytetarëve të Shkodrës.
Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpermjët një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**

Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit			Bashkia Shkoder				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	41,735			41,735		
A.2	Blerje vegla pune per sherbimin e gjelberimit						
A.3	Blerje aksesor per mjetet e punes se sherbimit te gjelbrimit	900			900		
A.3	Rehabilitim i sipërfaqeve të gjelbra të Bashkisë Shkodër						
Shuma		**42,635**			**42,635**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	41,735			41,735		
A.2	Blerje aksesor per mjetet e punes se sherbimit te gjelbrimit	900			900		
Shuma		**42,635**			**42,635**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	41,735			41,735		
A.2	Blerje aksesor per mjetet e punes se sherbimit te gjelbrimit	900			900		
Shuma		**42,635**			**42,635**		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likujdues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr.26	**P.AE141.Q6.O1.A2.**Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

I. Situata

Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore realizohet si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.
Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 650 m^2 në qytet ku përfshihen shatervani lulishte Parrucë dhe shatervani sheshi "Demokracia", si dhe mirëmbajtje sipërfaqe ujore Velipojë – 491 m^2.
Janë kryer sipas grafikëve të përcaktuar shërbimet për mirembajtjen e sipërfaqes ujore si pastrami me detergjentë, dezinfektimi.
Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave me mirëmbajtja e tyre.
Sherbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore në Plazhin Velipojë realizohet gjatë periudhës Maj-Tetor për të krijuar një mjedis më tërheqës për pushuesit e shumtë vendas dhe të huaj gjatë sezonit turistik.
Situata e vlerësuar:
Dëmtimi i shatervanëve nga persona të papërgjegjshëm në veshje dhe sprucatorët e hedhjes së ujit.
Ndotja e shatërvaneve dhe dëmtimet, shpesh nga papërgjegjëshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to dhe prishin aksesorët e shatërvanit.
Rikonstruksioni synon përmirësimin e estetikës urbane dhe ofrimin e një ambienti të sigurt dhe tërheqës për pushuesit gjatë sezonit turistik.

ii. Synimi i projektit

Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore me qëllim përmirësim të mëtejshëm të imazhit në lulishten e plazhit Velipojë dhe shatervanëve në qytet.
Planifikimi për shërbimin në vitin 2026:

(lekë)

Mirëmbajtje e Sipërfaqe ujore	765,000
Investime	0
TOTAL	765,000

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore në qytet dhe në lulishten e Plazhit Velipojë si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.
Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave dhe mirëmbajtja e tyre

b) Rezultatet që prisni

-Ofrim i shërbimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore në qytet dhe në lulishten e Plazhit Velipojë si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.
-Përmirësim I frekuencave të shërbimit me grafike të përcaktuar
-Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave dhe mirëmbajtja e tyre

c) Aktorët e mundshëm		**d) Kontributet e mundshme në projekt**					
Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni që ndjek shpenzimet: NSHPP		Bashkia Shkoder					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore	765			765		
A.2	Rehabilitim i sipërfaqeve ujore të Bashkisë Shkodër						
Shuma		**765**			**765**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore	765			765		
Shuma		765			765		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore	765			765		
Shuma		765			765		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028		**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit**: Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit **Institucioni likujdues**: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike					

Nr. 27	**P.AE141.Q6.O1.A3.** Ndertimi I tualeteve publike	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

- Bashkia jone pervec numrit te madh te banorve te vet, ndodhet ne nje situate te rritjes se interesin te turisteve vendes dhe te huaj per te vizituar. Ne kushte te tilla paraqesim problem mungesen e ambienteve te kryerjes se sherbimit per nevojat personale te njerezve. Kemi munges te tualeteve publike, gje qe ndikon negativisht ne performancen e sherbimeve te Bashkise. Per permisimin e kesaj situate duhet patjeter te realizohet ndertimi i disa tualeteve publike te shperndara ne disa pika te qytetit.
- Mendojme si fillim te ndertojme tre ambiente te tilla sherbimi, prane tre lulishteve kryesore te qytetit.
- Tualetet do ndertohen prane lulishtes perball Bashkise, tek Isa Buletini dhe lulishta pas dollarit.

ii. Synimi i projektit

Ne kuader te vleresimit te vlerave qe ka Bashkia jone , te rrisim performancen e sherbimit ndaj qytetarve dhe turisteve.
Realizimin si fillim te tre tualeteve publike ne qytet dhe ne perspektive rritja e numrit te tyre duke i ndertuar dhe ne zona te tjera me frekuentim turistik.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Për vitin 2026

- Hartimi i projekt preventivave .
- Realizimi i procedures se prokurimit
- Kryerja e investimit

b) Rezultatet që prisni:
Krijimii I ketyre ambienteve per kryerjen e kushteve te nje qendrimi normal neper qytet.
Permisimi I ketyre kushteve ne funksion te rritjes se numrit te vizitorve vendas dhe te huaj.

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
• Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	Buxheti i Bashkisë

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet sipas aktiviteteve 2026		Totali (000/lekë)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A1	Ndertim Tualete Publike	18,000			18,000
A1/1	Projektimi	750			750
A1/2	Mbikqyrja	292			292
A1/3	Kolaudimi	32			32
Shuma 2026		**19,074**			**19,074**

f) Periudha e zbatimit Viti 2026	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike **Institucioni likujdues:** Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike

Nr. 28	**P.AE141.Q7.O1.A1.**Shërbim i stafit të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Paga dhe shtesat mbi paga
Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të VKM nr. 113 dt.01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" ,VKM nr. 326 dt. 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike", VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, VKM nr.503 date 01.08.2024 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore
Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.
Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve
Paga,Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

b) Rezultatete pritshme

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.
Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Bashkia Shkoder

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026		Total (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transf	Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	**58,828**	58,828				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	**9,357**		9,357			
A.3.	Dieta për punonjësit	**55**			55		
Shuma		**68,240**	**58,828**	**9,357**	**55**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2027		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transf	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**58,828**	58,828				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**9,357**		9,357			
A.3	Dieta për punonjësit	**55**			55		
Shuma		**68,240**	**58,828**	**9,357**	**55**		

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2028		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transf	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	**58,828**	58,828				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore	**9,357**		9,357			
A.3	Dieta për punonjësit	**55**			55		
Shuma		**68,240**	**58,828**	**9,357**	**55**		

f) Periudha e zbatimit	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
Janar 2026 - Dhjetor 2028	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse **Institcioni likujdues:** Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike

Nr. 29	**P.AE141.Q7. O1.A2** Dekorimi i mjediseve publike	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Shërbimi i dekorit në Bashkinë Shkodër realizohet me burimet e veta financiare, përmes Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike me mjetet logjistike e fuqinë punëtore Drejtorisë së Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës. Me buxhetin e vitit realizohet blerja e aksesorëve të rinj me të cilët dekorohen sheshet dhe akset kryesore të qytetit. Pjesa tjetër e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët janë gjëndje dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit të dekorit. Me këto elementë zbukurues dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrethrrotullimet tek Ura e Bunës e Re, sheshi Bashlaj, sheshi Perash, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj.
Realizimi i dekorit bëhet me punonjësit e Drejtorisë së Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës ku pervec specialistëve të dekorit që punojnë me kohë të plotë gjatë kësaj periudhe, për për realizimin e shërbimit angazhohen dhe specialistët e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave.
Po ashtu vihen në dispozicion dhe mjetet logjistike të sektorit të Ndriçimit.
Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, realizohet është realizuar shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë dhe e Çlirimit si dhe aktivitete të tjera që organizohen nga Bashkia.
Për vitin 2025 është realizuar blerja e aksesorëve të dekorit për festat e fundvitit, blerja e materialeve për riparimin e aksesorëve që janë gjëndje, blerja e materialeve për montimin e aksesorëve, blerja e flamurëve kombëtar për dekorimin e rrugëve dhe shesheve.
Problemet e paraqituara:
Nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në rrugë e sheshe të tjera të qytetit si dhe në njësitë administrative të Bashkisë.
Amortizimi i elementëve të dekorit të blerë vitet e kaluara.
Nevoja për financime më të mëdha për realizimin e një dekori bashkëkohorë për të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.

ii. Synimi i projektit

Përmirësimi cilësor i dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditave.
Shtimi i numrit të aktiviteteve duke përfshirë edhe festat e ndryshme fetare me elementë dekorativ.
Shtimi i sipërfaqeve të dekoruara me rastin e festave tradicionale.
Zgjerimi i dekorit edhe ne Njësitë Administrative

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fundvitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit.
1. Blerje aksesorë dekori për festat:
Blerja e aksesorëve të dekorit , të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me aksesorë të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit.. Me këto elementë zbukurues dekorohen sheshet Parrucë, Bashlaj,Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrethrrotullimet tek Ura e Bunës e Re, sheshi Bashlaj, sheshi Perash, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj.
2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin:
Këtu përfshihen materialet e domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve që janë gjëndje të dekorit. Në zërat kryesorë të shpenzimeve përfshihen:
Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm).
Tel përcjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm.
Lidhëse kabllosh plastike.
Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.
Do të parashikohet blerja e aksesorëve të rinj për festat e fundvitit.
Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit

b) Rezultatet që prisni

Krijimi i dekorit më cilësor në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbanepër të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.;
Krijimi i dekorit më cilësor festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare si dhe aktivitete të tjera të që organizon bashkia.
Përmirësim dhe pasurim i dekorit në qytet dhe Njësi administrative

c) Aktorët e mundshëm	**d) Kontributet e mundshme në projekt**
Drejtorisë së ndriçimit rrugor dhe sinjalistikës Administratorët e NjA	Bashkia Shkodër Donatorët

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1 Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit.	4,200			4,200		
A.2 Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	800			800		

Shuma	**5,000**			**5,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1 Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit.	4,200			4,200		
A.2 Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	800			800		
Shuma	**5,000**			**5,000**		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1 Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit.	4,200			4,200		
A.2 Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	800			800		
Shuma	**5,000**			**5,000**		
f) Periudha e zbatimit Janar 2026 - Dhjetor 2028	**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit**: Drejtoria e Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës **Institucioni likujdues**: Ndermarrja e sherbimeve dhe Puneve Publike					

Nr. 30	**P.AE141.Q7.O1.A3** Mbeshtetje per infrastrukturën dhe shërbimet bazë të NSHPP	**Programi: AE141.** Shërbimet Publike Vendore

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Për funksionimin e Ndermarrjes kërkohet mbështetja dhe financimi për të gjitha shërbimet dhe mirëmbajtjen për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës. Për këtë kemi parashikuar ofrimin e shërbimeve në bazë të vlerësimit të nevojave, të planifikuara sipas zërave të aktiviteteve më poshtë:
Nevoja për kancelari për përmbushjen e detyrave dhe rritjen e performancës në punë.
Materiale hidraulike Pompa uji, rubinetë, mishelatorë të ndryshëm, shkarkues banjo, tuba të ndryshëm fleksibël, vegla pune, çelës hidraulik, pincë hidraulike, etj. Gjithashtu Lyerjen e ambjenteve here pas here, shfaq nevojën për blerjen e artikullit bojë, stuko etj.
Për të krijuar kushte sa më normale higjienike kemi vlerësuar nevojën e blerjes së materialeve që do mundësojnë mbajtjen në kushte higjienike normale është parashikuar blerja e materialeve të pastrimit dhe dezinfektantëve.
Është bërë planifikimi për shërbimin e internetit per nevoja gjate gjithe vitit te NSHPP.
Gjithashtu në përmirësimin e kushteve të punës kërkojmë mirembajtjen e pajisjeve TIK.
Në zbatim të standarteve ligjore dhe kushteve teknike duhet qe per fikse zjarrri te realizohet mirembjatja duke realizuar sherbimin e rimbushjes dhe të çertifikohen (kolaudohen).
Për arsye monitorimi dhe efikasiteti në përdorimin sa më efiçent të automjeteve në dispozicion të NSHPP kërkohet të kryhet shërbimi i monitorimit me GPS. Ky shërbim do të përfshijë monitorimin e konsumit të karburantit, kilometrave, vendodhjes dhe orëve të punës.
Nisur nga fakti që ambjenti ku ndodhet NSHPP ka nevojë për përmirësimtë rrejti të brendshëm LAN dhe Survejimi, shtim linjash, zëvendësim linja të amortizuara ose jashtë funksioni, krijim kabineti TIK . Për kë arsye kërkohet të pështatet ambjenti që do të ketë Rack, NVR, Switch, NAS, Inverter, pajisje për mbrojtjen nga mbi tensioni dhe akses kontroll.
Për arsye të funksionimit sa më efikas në punë tek zyra e Financës kërkohet një sistem për menaxhimin financiar të NSHPP.
Parashikimi i shpenzimeve për shërbimet e nevojshme që ndërmarrja ka në funksionin e saj, zë një vend të rëndësishëm për mirëfunksionimin dhe kryerjen e detyrave të përditshme të saj. Kërkesat dhe nevojat që ka ndërmarrja për vazhdimësinë e punës renditen si më poshtë vijon:
Furnizimi me ujë dhe likujdimi i faturave të ujit i cili është bërë korrekt dhe në kohë.
Shërbimet postare mundësojnë dërgimin e dokumentacionit zyrtar, si domosdoshmëri e ushtrimit të funksioneve të saj.
NSHPP ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik.
Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive si zjarri apo katastrofa të tjera natyrore.

ii. Synimi i projektit

Përmirësimi i plotësimit të nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit
Të krijohen kushte normale pune dhe në përmirësim të vazhdueshëm në funksion të rritjes së performancës së saj në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit.
Sigurimi i shërbimeve bazë (ujë, komunikim postar, etj) për përmbushje të kushteve fizike normale gjatë kryerjes së funksioneve dhe detyrave të tyre të përditshme.
Sigurimi i ndërtesës dhe inventarit të tyre ekonomik, për mbrojtjen e tyre në rast dëmtimesh fizike si p.sh: zjarri apo katastrofa të tjera natyrore.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime;
Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit;
Marrja dhe vlerësimi i kërkesave për këto shërbime nga të gjitha drejtoritë.
